



**Në përputhje me nenin 7.pika 2. Statutit të KRU"Hydroregjioni jugor"Sh.A., me datë 20.05.2011, Bordi i Drejtorëve të KRU"Hydroregjioni jugor"Sh.A.me seli në Prizren, aprovoi këtë:**

## **RREGULLORE PËR MBROJTJE NË PUNË**

### **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

Me qëllim të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të punëtorëve nga lëndimet në punë, si dhe nga sëmundjet profesionale, evitimin e shkaqeve të lëndimeve dhe dëmtimeve të shëndetit në punë, të krijimit të kushteve sa më të mira të punës në Kompani, zbatohet mbrojtja në punë në bazë të ligjit(Ligji nr.2003/19), kësaj Rregulloreje dhe akteve tjera të përgjithshme.

#### **Neni 2**

Mbrojtja në punë përfshinë masat preventive, të përgjithshme dhe të posaçme, që janë me ndikim në krijimin e kushteve të sigurta të punës, posaçërisht për caktimin e të drejtave dhe të obligimeve të punëtorëve, për shkak të shkeljes eventuale të obligimeve të mbrojtjes në punë, organizimin e punëve të mbrojtjes në punë, detyrave të organeve të qeverisjes, procedura e aprovimit të planeve dhe programeve për mbrojtjen në punë, vendet e punës me kushte të posaçme, aftësimi i punëtorëve për mbrojtje në punë, rastet me të cilat punëtorit i ndalohet kryerja e punëve, kontrollimi i kohëpaskohshëm dhe testimi i mejetëve të punës dhe paisjeve, mbrojtja e posaçme e grave, të rinjëve dhe invalidëve, si dhe masat tjera të caktuara me ligj dhe këtë Rregullore.

#### **Neni 3**

Organizimi dhe procesi i punës në Kompani, mbështetet në të arriturat shkencore-teknike, e posaçërisht në masat dhe normat e mbrojtjes që kanë të bëjnë me veprimtarin në Kompani, e cila u siguron punëtorëve mbrojtjen e duhur në punë. Në çdo rast të riorganizimit të punës, respektivisht të procesit teknologjik, rikonstruktimit dhe blerjes së mjeteve të reja të punës në Kompani, duhet të zbatohen dhe sigurohen masa përkatëse të mbrojtjes në punë.

#### Neni 4

Procesi teknologjik, duhet të organizohet në mënyrë që secili punëtor të punojë pa rrezik për shëndetin dhe jetën e tij dhe të punëtorëve të tjerë. Përparimi i organizimit dhe procesit të punës me të cilin garantohet siguria e punëtorëve në punë, është detyrë themelore e drejtuesëve, udhëheqësve të njësive dhe përgjegjësve tjerë të Kompanisë.

#### Neni 5

Personat përgjegjës në Kompani bëjnë zbatimin dhe përparimin e masave të mbrojtjes në punë, me ndihmën profesionale të Referentit për mbrojtje në punë, mjekut, si dhe angazhimin e organizatave të specializuara shkencore dhe shëndetësore.

#### Neni 6

Dispozitat e kësaj Rregullore aplikohen për të gjithë punëtorët e Kompanisë, të cilët në çfardo baze punojnë, si stafi i rregullt punuës, nxënës të shkollave të mesme dhe student, të cilët gjatë kryerjes së punëve profesionale apo provuese si praktikant ndodhen në punë praktike apo trajnim në Kompani.

### **TË DREJTAT, OBLIGIMET DHE PËRGJEGJËSIT E PUNËTORËVE LIDHUR ME MROJTJEN NË PUNË**

#### Neni 7

Punëtorët kanë të drejta dhe obligime që:

- Me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës, të jenë të përgaditur nga lëmi i mbrojtjes në punë dhe gjatë punës të plotësojnë njohuritë e tyre. Lidhur me këtë çështje;
- Detyrimisht të shfrytëzojnë mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes personale për punët që kryejnë;
- Para fillimit të punës të vërtetojnë gjendjen e mjetëve të punës dhe pajisjeve, mjeteve dhe veglave të mbrojtjes personale;
- Në rast defekti të mjeteve të mbrojtjes personale dhe veglave, mjeteve, pajisjeve të punës, menjëherë të informojnë udhëheqësin e drejtpërdrejt dhe Referentin për mbrojtje në punë;
- Me rastin e lëndimit në punë, fatkeqësisë kolektive, fatkeqësive elementare e të ngjashme, të ndihmojnë në evitimin e pasojave.

#### Neni 8

Punëtori është i obliguar që punën e tij ta kryej me kujdes të plotë dhe pa rrezik për jetën dhe shëndetin e tij, të punëtorëve të tjerë të cilët ndodhen rreth tij, si dhe pa i dëmtuar mjetet me të cilat drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthort punon.

#### Neni 9

Punëtori është i obliguar që tu përmbahet të gjitha masave, normave dhe udhëzimeve të parapara për siguri në punë, që të kujdeset për zbatimin e masave mbrojtëse në punë, ti kryej vizitat e rregullta mjekësore me qëllim të kontrollimit të gjendjes shëndetësore të tij.

#### Neni 10

Punëtori është i obliguar që t'i shfrytëzoj të gjitha mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes personale të punës, t'i shfrytëzoj ato për qëllimin e dedikuar, t'i përdorë me kujdes, që t'i mbajë ato në gjendje funksionale dhe që të mos i ndërrojë me punëtorë tjerë.

#### Neni 11

Nëse punëtori vlerëson se i kanoset rreziku i drejtpërdrejt për jetën ose shëndetin, për shkak se mungojnë masat e nevojshme mbrojtëse në punë, ai ka për detyrë që këtë vlerësim t'ia paraqet punëdhënësit të tij.

Në qoftëse nuk zbatohen masat e sigurisë dhe të metat nuk evitohen, ai ( punëtori ) ka të drejt të refuzojë punën derisa të metat të evitohen.

Punëtori ka të drejtë të refuzojë punën me mjetin e punës me fuqi të mekanizuar, në të cilin nuk janë vendosur mjetet e parapara mbrojtëse, derisa ato mjete nuk vendosen sipas kushteve të parapara për siguri në punë.

#### Neni 12

Punëtori i cili ka ndonjë problem shëndetsorë i cili nuk mund të konstatohet në shikimin e rregullt mjekësor, është i obliguar që ato probleme shëndetsore respektivisht sëmundje, t'i paraqes para fillimit të punës.

Në qoftëse punëtori nuk vepron sipas paragrafit të mësipërm, ndërsa të metat respektivisht sëmundjet janë të natyrës së tillë që mund ta pengojnë në punë, punëtori mund të caktohet në vend tjetër të punës.

#### Neni 13

Punëtori është i obliguar, që pa vonesë të lajmrojë për çdo lëndim që i ndodh në punë Udhëheqësit të drejtpërdrejt ose Referentit të marrëdhënies për mbrojtje në punë.

#### Neni 14

Punëtori është i obliguar ta lëshoj punën, nëse atë e kërkon Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt në rastet kur:

- Nuk i zbaton masat e parapara të mbrojtjes në punë;
- Nuk i shfrytëzon mjetet e mbrojtjes personale;
- Nuk është i aftë për punë, sepse gjendet në gjendje të tillë psiko-fizike, për shkak të së cilës rrezikon veten, punëtorët tjerë rreth tij dhe mjetet e punës.
- Punëtori i cili është nën ndikimin e alkoolit ose narkotikëve, nuk mund të filloj punën.

## **PËRCAKTIMI I SHKELJES SË OBLIGIMEVE NË PUNË LIDHUR ME MBROJTJEN NË PUNË**

### **Neni 15**

Shkeljet e detyrave të punës nga lëmi i mbrojtjes në punë duke marrë për bazë peshën dhe pasojat, mund të jenë të lehta dhe të rënda.

Punëtori bën shkelje të lehta të obligimeve në punë, nga mbrojtja në punë:

- Në qoftëse se paisjet për mbrojtje personale nuk i shfrytëzon për qëllime të dedikuara;
- Në qoftëse me pakujdesi i përdorë mjetet e mbrojtjes personale ose ato qëllimisht nuk i mban në gjendje të rregullt;
- Nëse qëllimisht ose me pandërgjegjësi i kryen obligimet e punës, pa përfillur mbrojtjen në punë;
- Në qoftëse në çfardo mënyre me papërgjegjësi sillet ndaj aplikimit të masave të mbrojtjes e që nuk kanë pasoja të rënda.

### **Neni 16**

Punëtori bën shkelje të rëndë të detyrave të punës nga mbrojtja në punë:

- Në qoftëse edhe pas vërejtjes refuzon të shfrytëzoj mjetet e mbrojtjes personale;
- Në qoftëse nuk u nënshtrohet kontrollimeve të obligueshme të kohë paskohëshme mjekësore;
- Në qoftëse nuk merr pjesë në aftësimin e organizuar për mbrojtjen në punë dhe nuk i nënshtrohet verifikimit të njohurive të fituara;
- Në qoftëse personit përgjegjës nuk ia paraqet dukurit të cilat mund të shkaktojnë fatkeqësi në punë;
- Në qoftëse edhe përkundër vërejtjes, i heq aparatet dhe mjetet mbrojtëse në vendin e punës;
- Në qoftëse në punët me rrezik të shtuar edhe përkundër njohurisë se nuk janë siguruar masat e mbrojtjes në punë, vazhdon të punoj dhe për këtë arsye shkaktohen pasoja të rënda për punëtorët dhe pronën,
- Në qoftëse pa arsye refuzon ekzekutimin e vendimeve, udhëzimeve ose urdhërave për mbrojtje dhe siguri në punë, të cilat i bien organet kompetente ose personi përgjegjës;
- Në qoftëse nuk ndërpre punën derisa ndodhet nën ndikimin e alkoolit ose narkotikëve, pasi që udhëheqësi t'i ketë urdhëruar ndërprerjen e punës;
- Në qoftëse në çfardo mënyre nuk i kryen obligimet e parapara me këtë Rregullore, për ç'arsye shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin ose jetën e punëtorëve, ose për këtë arsye Kompania pëson dëm material.
- Për shkelje të rënda të obligimeve nga mbrojtja në punë, punëtorit mund t'i shqiptohet masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

### **Neni 17**

Drejtorët dhe punëtorët tjerë përgjegjës, bëjnë shkelje të lehta të obligimeve të punës nga mbrojtja në punë, në rast të mos zbatimit të masave mbrojtëse në punë, që janë paraparë për të gjithë punëtorët dhe në qoftëse nuk i kryejn detyrat e tyre, për ç'arsye mund të shkaktohen pasojat e dëmshme për shëndetin e punëtorëve ose dëme të vogla materiale.

#### Neni 18

Drejtori dhe punëtorët tjerë përgjegjës bëjnë shkelje të rëndë të detyrave të punës nga lëmi i mbrojtjes, në qoftë se për shkak të mos kryerjes së obligimeve që janë paraparë për të gjithë punëtorët ose vendet e punës, shkaktohet lëndim i rëndë në punë ose vdekja e punëtorit.

Për shkelje të rëndë të obligimeve nga mbrojtja në punë, mund të shqiptohet masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

#### Neni 19

Procedura për vërtetimin e shkeljeve në punë nga mbrojtja në punë, si dhe shqiptimi i masave disiplinore bëhet sipas dispozitave ligjore dhe Rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të K.R.U. " Hidroregjioni Jugor" SH.A. Prizren.

### **TË DREJTAT, OBLIGIMET DHE PËRGJEGJËSIA E PERSONAVE PËRGJEGJËS**

#### **1. Kryeshefi Ekzekutiv**

##### Neni 20

Kryeshefi Ekzekutiv ka të drejtë dhe obligim:

- Që përmes Drejtorëve të drejtorive punuese dhe udhëheqësve të sektorëve, të organizoj dhe të siguroj zbatimin e dispozitave ligjore në punë dhe dispozitave të kësaj Rregulloreje;
- Të siguroj mjete financiare dhe blerjen e mjeteve dhe të pajisjeve për mbrojtje në punë;
- Të siguroj zbatimin e vendimeve të Bordit të Drejtorëve nga lëmia e mbrojtjes në punë;
- Që me ndihmën e Shërbimit profesional ose të Referentit për mbrojtje në punë, të punojnë në drejtim të avancimit të masave dhe mekanizmave të mbrojtjes në punë.

#### **2. Drejtori i Drejtorive Punuese**

##### Neni 21

Udhëheqësi i Njesisë punuese është përgjegjës për zbatimin dhe aplikimin e masave të mbrojtjes në punë dhe për sigurinë e punëtorëve e posaqërisht është i obliguar:

- Të siguroj kontrollimin periodik të mjeteve të punës;
- Të krijoj sigurinë në punë për punët ku kanoset rreziku për shëndetin dhe jetën e punëtorëve;
- Të propozoj masa për mbrojtje në punë për punëtorët e njesisë së vet dhe të kujdeset për zbatimin e tyre;
- Të bëj fletparaqitje kundër punëtorëve të cilët nuk i aplikojnë dispozitat e mbrojtjes në punë.

### **3. Shefi i Shërbimit**

#### **Neni 22**

Për zbatimin e dispozitave ligjore nga mbrojtja në punë dhe dispozitave të kësaj Rregulloreje, janë përgjegjës edhe shefat dhe udhëheqësit e ndrrimeve, secili nga fushveprimtaria e vet.

Përsoneat përgjegjës nga paragrafi i mësipërm, në zbatimin korrekt të masave të mbrojtjes në punë, kanë obligim që:

- Punëtorin ta njoftojnë në mënyrë të drejtëdrejtë me kushtet e punës dhe burimet e rrezikut dhe të ndikimit të dëmshëm të vendit të punës;
- Punëtorin ta aftësojë për mënyrën e përdorimit dhe dedikimin e mjeteve përkatëse dhe të pasjisjeve të mbrojtjes personale, si dhe për pasojat eventuale në rast të mospërdorimit të tyre;
- Vazhdimisht dhe pandërprerë të mbikqyrin zbatimin e masave të parapara të mbrojtjes në punë;
- Të mos i lejojnë punëtorit i cili nuk i shfrytëzon mjetet e mbrojtjes në punë, që të punojë në vendin e punës;
- Kohë pas kohe gjatë punës ta kontrollojnë shkallën e përgaditjes së punëtorëve, lidhur me mbrojtjen në punë;
- Menjëherë dhe pa shtyrje, e më së voni në afat prej 24 orësh, të informojnë Referentin e mbrojtjes në punë për çdo aksident në punë;
- T'i paraqesin udhëheqësit përgjegjës, mungesën, prishjen ose dukurinë e cila mund të rrezikoj jetën ose shëndetin e punëtorëve;
- Të kujdesen për paisjen e barnatorës doracake;
- Në rast fatkeqësie, t'i ofrojnë ndihmë të lënduarit;
- T'i bëjnë fletparaqitje personit përgjegjës për shkelje të detyrave të punës kundër punëtorëve që nuk u përmbahen masave të parapara të mbrojtjes në punë, e posaçërisht kundër atyre që refuzojnë përdorimin e mjeteve dhe paisjeve të mbrojtjes personale;
- Me prezencën dhe mbikqyrjen e tyre, të krijojnë sigurinë e zbatimit të operacioneve të punës, e posaçërisht të punëve të rrezikshme.

#### **MASAT KUNDËR PUNËTORIT PËR SHKAK TË MOSPËRMBAJTJES SË OBLIGIMEVE TË MBROJTJES NË PUNË**

#### **Neni 23**

Punëtori përgjegjës nga neni 22 i kësaj Rregulloreje, ka te drejtë dhe obligim të ndalojnë punën punëtorit në këto raste:

- Në qofte se nuk respekton dispozitat nga mbrojtja në punë dhe kryen punë kundër masave të sigurisë, për ç'arsye mund të lëndohet personalisht ai apo rrezikon të lëndohen punëtorët tjerë;
- Nëse kryen punë pa mjete të mbrojtjes që i ka në posedim, por nuk i shfrytëzon ato;

- Në qoftë se refuzon të veproj sipas udhëzimeve për punë të sigurt që i jep Udhëheqësi i drejtpërdrejt;
- Në qoftë se konstatohet se ka ndërprerë, hequr ose asgjeluar mjetin e mbrojtjes ose pajisjen dhe punon pa mbrojtje, dhe
- Kur punëtori i drejtpërdrejt përgjegjës konstaton se punëtori ka ardhur në gjendje të dehur ose nën ndikimin e narkotikëve ose është dehur gjatë orarit të punës.
- Largimi nga puna zgjatë derisa të konstatohet se punëtori sërish është i aftë për punë, respektivisht, se ka pushuar ndikimi i shkaqeve për të cilat ka qenë i larguar.

#### Neni 24

Në qoftë se punëtori, në rastet nga neni paraprak kundërshton kërkesën për largim nga puna, ndërsa konstatohet se është vepruar në harmoni me dispozitat e nenit paraprak, udhëheqësi me ndihmën e Shërbimit të Sigurisë do ta largojë punëtorin nga vendi i punës.

#### Neni 25

Kundër punëtorit që është larguar nga puna në kuptim të nenit të mësipërm, bëhet fletëparaqitja për shkelje të rëndë të obligimit në punë, ndërsa punëtori i autorizuar fillon procedurën disiplinore në harmoni me dispozitat e Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të punëtorit.

### **TE DREJTAT DHE OBLIGIMET E BORDIT TË DREJTORËVE**

#### Neni 26

Bordi i Drejtorëve në harmoni me të drejtat dhe obligimet që ka, kujdeset për zbatimin dhe përparimin e mbrojtjes në punë dhe për këtë qëllim:

- Shqyrton dhe aprovon masat për mbrojtje në punë dhe kujdeset për realizimin e tyre;
- Lejon mjetet financiare për realizimin e masave të mbrojtjes në punë;
- Shqyrton gjendjen e lëndimeve në punë, të sëmundjeve profesionale, të kushteve të punës, aprovon masat për evitimin e të metave dhe parregullësive të konstatuara;
- Shqyrton raportet që bënë Inspekcioni kompetent i Punës dhe organet tjera për gjendjen e mbrojtjes në punë dhe merr vendime në harmoni me kërkesat dhe sygjerimet e atyre organeve;
- Merr masa përmes organit kompetent për fillimin e procedurës në rast të shkeljes së obligimeve të sigurisë në punë, për shkak të mos përmbajtjes së masave mbrojtëse në punë;
- Mund të emëroj komisionin për mbrojtje në punë;
- Bënë analizën e gjendjes së mbrojtjes;
- Në mbledhjen e parë pas rastit të fatkeqësisë në punë ose lëndimit të rëndë, shqyrton shkaqet e fatkeqësisë dhe ndërmerr masa për evitimin e të metave.

#### Neni 27

Me qëllim të realizimit më efikas dhe të shpejtë të detyrave nga neni i mësipërm Bordi i Drejtorëve mundë të emëroj komisionin për mbrojtje në punë.

#### Neni 28

Komisioni për mbrojtje në punë kryen këto detyra:

- Propozon masa e programe për mbrojtje në punë;
- I paraqet raport vjetor Bordit të Drejtorëve për gjendjen dhe problemet e mbrojtjes në punë;
- Përcjell realizimin e masave dhe programeve të mbrojtjes në punë;
- Shqyrton raportet, propozimet, ankesat dhe parashtrirat lidhur me mbrojtjen në punë dhe mendimet dhe propozimet e veta ia paraqet Bordit të Drejtorëve për miratim;
- Bënë kontrollën në reparte të Kompanisë dhe për këtë i raporton Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit të Kompanisë me propozime dhe sygjerime për evitimin e të metave eventuale;
- Kryen edhe punë të tjera lidhur me mbrojtjen në punë.

### **ORGANIZIMI I KRYERJES SË PUNËVE TË MBROJTJES NË PUNË**

#### Neni 29

Punët nga mbrojtja në punë, fushveprimi dhe autorizimet e punëtorëve që i kryejn ato punë, përcaktohen me këtë Rregullore dhe Vendimin për sistematizimin e vendeve të punës.

Këto punë i kryen Referenti i mbrojtjes në punë.

#### Neni 30

Kompania është e obliguar që në harmoni me ligjin, të autorizoj Referentin për mbrojtje në punë për t'i vizituar të gjitha repartet dhe vendet e punës dhe të kontrolloj aplikimin e masave të mbrojtjes në punë. Në bazë të këtij kontrolli ai duhet të bëjë raporte dhe lidhur me to, ti informojë personat përgjegjës. Në raportet e tij, ai posaqërisht do të theksojë të metat dhe moszbatimin e masave të mbrojtjes në punë nga ana e punëtorëve të caktuar.

#### Neni 31

Referenti i mbrojtjes në punë për realizimin e kushteve të sigurisë në punë, ka këto detyra:

- Përgadit informata dhe planifikon masat e mbrojtjes në punë;
- Bashkëpunon me Shërbimin juridik, për hartimin e akteve nga lëmi i mbrojtjes në punë;
- Merr pjesë në organizimin e trajnimit të punëtorëve, lidhur me mbrojtjen në punë dhe për këtë mban evidencë;
- Merr pjesë në organizimin e zbatimit të masave të mbrojtjes në punë dhe jep propozime për sigurimin e kushteve të mbrojtjes në vendet e punës;
- Merr pjesë në organizimin e kontrollit periodik të mjeteve të punës dhe paisjeve si dhe të kushteve të punës, ku lidhur me këtë mban evidencë;
- Kryen punë të mbrojtjes preventive (para fillimit të punëve), informon lidhur me aplikimin e masave të mbrojtjes në punë;

- Përmes Udhëheqësit të shërbimit të mirëmbajtjes, ndikon që të zbatohen masat e mbrojtjes në punë në procesin e punës të mjeteve të punës, paisjet dhe veglat e punës dhe për to mban evidencë;
- Kudeset për evidencën e lëndimeve në punë dhe të sëmundjeve, që kanë të bëjnë me punën e punëtorëve;
- Merr pjesë në kryerjen e detyrave tjera që burojnë nga Ligji, Rregullorja, vendimet e organeve të qeverisjes etj.

#### Neni 32

Personi i autorizuar nëse vëren se punëtorit në punë i kanoset rreziku për jetë ose shëndet, e informon për rastet e tilla Udhëheqësin ose personin përgjegjës, ndërsa punëtorin e largon nga ajo punë, derisa të ndërmerren masat e parapara të mbrojtjes dhe sigurisë në punë.

### **PLANI DHE PROGRAMI I MASAVE TË MBROJTJES NË PUNË**

#### Neni 33

Planet dhe programet e masave të mbrojtjes në punë, aprovohen sipas procedurës së caktuar për aprovimin e planeve dhe programeve të zhvillimit respektivisht të punës. Plani i mbrojtjes në punë aprovohet në periudhën prej 5 vjetësh, ndërsa programet e masave të mbrojtjes në punë për periudha 1 vjeqare.

#### Neni 34

Plani i mbrojtjes në punë përmban detyrat për përmirësimin e kushteve të punës dhe masave të mbrojtjes, me të cilat mundësohet puna e sigurtë e punëtorëve e posaqërisht:

- Avancimi teknologjik i veglave dhe pajisjeve për punë dhe ambient të punës;
- Aftësimi dhe zgjerimi i njohurive të punëtorëve nga lëmi i mbrojtjes në punë;
- Përmirësimin e kushteve për shëndetin e punëtorëve në punë;
- Përmirësimi i sigurisë dhe kushteve të punës, kryerja e të cilave mund të shkaktojë sëmundje dhe lëndime gjatë punës;
- Zgjidhja e problemit të ushqimit, pushimit, rekreacionit dhe të nevojave tjera të punës dhe jetës së punëtorëve, me qëllim të kushteve të sigurta në punë;
- Sigurimin e mjeteve për kryerjen e detyrave të planifikuara.

#### Neni 35

Programi i masave të mbrojtjes në punë, përcakton obligimet dhe detyrat nga plani i mbrojtjes në punë, të cilat duhet kryer në periudhën për të cilën programi aprovohet, afatin, mënyrat e kryerjes së obligimeve dhe detyrat, si dhe cakton organet dhe punëtorët që janë përgjegjës për realizimin e tij.

#### Neni 36

Programi i masave të mbrojtjes në punë përmban:

- Procedurën, mënyrën dhe afatin e evitimit të të metave në lëmin e mbrojtjes në punë, posaqërisht të atyre të cilat i ka theksuar inspekcioni kompetent;
- Dinamikën dhe afatet e kontrollimeve mjekësore të punëtorëve;
- Dinamikën e kontrollimit të ambientit të punës, posaqërisht për vendet e punës me kushte të posaçme të punës;

- Duke caktuar kryersin e kësaj pune (qoft nga punëtorët e Komapnisë ose nga ente të autorizuara);
- Dinamikën e aftësimin të punëtorëve nga lëmi i mbrojtjes në punë, si dhe orarin e vërtetimit të njohurive nga kjo materie;
- Burimet e mjeteve finaciare për zbatimin e masave të mbrojtjes në punë, dhe
- Masat e parapara me këtë Ligj dhe këtë Rregullore.

## **AFTËSIMI I PUNËTORËVE PËR MBROJTJE NË PUNË DHE NJOHJA E TYRE ME KUSHTET E PUNËS DHE BURIMET E RREZIKUT**

### Neni 37

Në harmoni me dispozitatat ligjore të mbrojtjes në punë, kompania është e obliguar që të njoftoj punëtorin me kushtet e punës, rreziqet lidhur me punën, respektivisht vendin e punës dhe t'i sigurojë punëtorit aftësimin nga lëmi i mbrojtjes në punë, si para caktimit në vendin e punës ashtu edhe gjatë punës së tij.

### Neni 38

Para caktimit të vendit të punës, punëtori duhet të njoftohet me:

- Procesin teknologjik të punës në tërësi, posaçërisht me organizimin e punës dhe mënyrën më të drejtë të punës (ardhjen në vendin e punës, lëvizjen në vendin dhe ambientin e punës, mënyrën e kryerjes së punës) etj.;
- Dispozitat e përgjithshme dhe të posaçme, masat dhe udhëzimet e mbrojtjes në punë, si dhe me obligimin që në punë duhet t'u përmbahet atyre, me pasojat që mund të rrjedhin nga mospërmbajtja e masave të mbrojtjes në punë;
- Mjetet personale dhe kolektive të mbrojtjes, pajisjet dhe veglat për mbrojtje në punë, që është i obliguar t'i shfrytëzojë në vendin e punës, mënyrën e përdorimit të tyre dhe shfrytëzimin e tyre të dedikuar;
- Të drejtat dhe obligimet nga lëmi i mbrojtjes në punë;
- Masat e tjera që mund të jenë të rëndësishme për mbrojtje në punë.

### Neni 39

Kompania është e obliguar që të kujdeset për aftësimin e punëtorëve nga lëmi i mbrojtjes në punë, posaçërisht;

- Në rast të ndërrimit të procesit teknologjik;
- Shfrytëzimit të mjeteve dhe pajisjeve të reja të punës;
- Ndërrimit të organizimit të punës;
- Kryerjes së rekonstruktiveve, adaptimeve etj.;
- Ndërrimit të kushteve të punës;
- Caktimit të dispozitave të reja të mbrojtjes në punë ose të ndërrimit apo plotësimit të tyre, e që kanë të bëjnë me punën e punëtorit në vend të caktuar të punës.

## **1. Programi aftësimi**

### Neni 40

Programi i aftësimi të punëtorëve nga lëmi i mbrojtjes në punë, përcaktohet në bazë të nevojave të Kompanisë.

Programet e tilla duhet të jenë në harmoni me punët që punëtorët duhet t'i kryejnë në sektorët dhe njësitë e caktuara punese.

Disa tema të arsimimit nga kjo lëmi, mund të jenë të përbashkëta për tërë Kompaninë.

### Neni 41

Aftësimi i punëtorëve për mbrojtje në punë, përbëhet nga pjesa praktike dhe teorike.

Aftësimi mund të bëhet për të gjitha kategoritë e punëtorëve të kompanisë.

### Neni 42

Pjesa teorike e programit të aftësimi nga mbrojtja në punë, varësisht nga puna respektivisht vendi i punës dhe burimi i rrezikut, mund të përmbajë:

- Fazat e mbrojtjes në punë dhe shkaqet për të cilat zbatohet;
- Rreziqeve që u nënshtrohet punëtori gjatë kryerjes së punës dhe mënyra e mbrojtjes;
- Udhëzimet për shfrytëzimin e drejtë të mjeteve personale të mbrojtjes dhe të mjeteve ndihmëse teknike në vendin e punës;
- Mënyra e ofrimit të vetëndihmës dhe ndihmës së parë;
- Shpëtimi i punëtorëve në rast të fatkeqësive elementare dhe mënyra e evakuimit në rast të zjarrit, eksplozimeve apo dukurive tjera që mund të rrezikojnë numër më të madh të punëtorëve;
- Të drejtat e punëtorëve dhe obligimet e tyre lidhur me mbrojtjen në punë dhe mënyra e realizimit të atyre të drejtave, si dhe
- pasojat në rast të shkeljes së obligimeve nga mbrojtja në punë.

### Neni 43

Programin e aftësimi, plotësimet dhe ndryshimet e tij, i bën referenti i mbrojtjes në punë, ndërsa e aprovon Bordi i Drejtorëve.

Në hartimin dhe zbatimin e programit të aftësimi të punëtorëve, sipas nevojës mund të aftësohen dhe shërbime e bashkpunëtorë të jashtëm professional.

## **2. Procedura e aftësimi**

### Neni 44

Me rastin aftësimi teorik të punëtorëve, ata në mënyrë të përshtatshme njoftohen me materien e mbrojtjes në punë, e cila është paraparë për ta.

### Neni 45

Aftësimi praktik zbatohet kur vlerësohet se punëtori në aspektin teorik është informuar me materien e mbrojtjes në punë.

Në rastet kur Udhëheqësi i drejtpërdrejt bën vet-aftësimin e punëtorëve, zgjidhen metodat më të mira të aftësimit praktik të punëtorëve në vendin e punës, duke u nisur nga ndërlíkueshmëria dhe natyra e punës.

### **3. Vërtetimi i njohurive**

#### **Neni 46**

Kompania është e obliguar që vërtetimin e aftësimit të punëtorëve për punë të pavarur dhe të sigurtë, ta bëjë në harmoni me ligjin për mbrojtjen në punë, ashtu që vërtetimi të zgjerohet edhe në aplikimin praktik të masave të parapara të mbrojtjes në punë, si dhe, vërtetimi i pjesës teorike të përfshijë të gjitha çështjet e rëndësishme e të nevojshme për kryerjen e pavarur dhe të sigurtë të punëve të besuara.

#### **Neni 47**

Pas vërtetimit të njohurive teorike për mbrojtje në punë, Udhëheqësi i drejtpërdrejt ose punëtori të cilin ai e autorizon, bën vërtetimin e aftësimit të punëtorëve për punë të pavarur në aspektin praktik, drejtpërsëdrejti në vendin e punës në të cilin punëtori duhet të punojë.

#### **Neni 48**

Vërtetimi i aftësimit teorik dhe praktik, bëhet tek punëtorët të cilët punojnë me procese të ndërruara teknologjike, para se të fillojnë punën e pavarur në vendet e tilla. Vërtetimi në punën praktike bëhet ashtu që, punëtori i caktuar, në punën e vet praktike tregon se është në gjendje t'i kryej të gjitha operacionet teknologjike në mënyrë të sigurtë dhe të pavarur. Puna praktike zbatohet në të gjitha njësit punese si dhe për punët që punëtori do t'i kryej në punën e përditshme.

#### **Neni 49**

Punëtori i cili sipas vlerësimit nuk tregon aftësim të mjaftueshëm, duhet sërish t'i nënshtrohet aftësimit. Në rast se edhe pastaj nuk tregon se është aftësuar, do të vendoset në bazë të dispozitave të akteve tjera të përgjithshme, se në cilin vend punë do të caktohet punëtori i tillë.

### **4. Njohja e punëtorëve me rreziq në vendin e punës**

#### **Neni 50**

Para caktimit në punë tjera, respektivisht në vend të ri të punës, punëtori duhet të informohet me të gjitha burimet e rrezikut në punë, posaqërisht me rreziqet për jetë dhe shëndet që mund të paraqiten gjatë kryerjes së punës në atë vend, si me shfrytëzimin e mjeteve të rrezikshme për punë dhe paisjeve ashtu edhe me shfrytëzimin e materialeve.

#### Neni 51

Me burimet e rrezikut në repartet, respektivisht në vendin e punës, punëtori njoftohet gjatë aftësimit nga lëmi i mbrojtjes në punë.

#### Neni 52

Para caktimit të punëtorit në punë të re, personi përgjegjës vërteton njohurinë e punëtorit për rreziqet lidhur me atë vend pune dhe aty për aty i shpjegon dhe njofton me burimet e rrezikut, duke ia paraqitur ato në mënyrë të përshtashme, si dhe informon me pasojat eventuale për shëndetin në rast se nuk është i kujdesshëm në punë, respektivisht në rast se nuk shfrytëzon pajisjet dhe mjetet për mbrojtje personale.

#### Neni 53

Në qofte se udhëheqësi i drejtpërdrejt vlerëson se punëtori i cili është caktuar në vend punë në kushte të posaçme nuk është sa duhet i kujdesshëm për kryerjen e atyre punëve, ku për këtë arsye i kanson rreziku nga lëndimet në punë, do t'i propozojë udhëheqësit të njësisë, që punëtori i tillë të caktohet në punë tjera.

#### Neni 54

Udhëheqësi i drejtpërdrejt është i obliguar që me vëmendje të posaçme të përcjellë punën e punëtorëve të ri, në vendet e punës me kushte të posaçme dhe atë ta vizitojë më shpesh gjatë punës e sipas nevojës, t'i përsëris vërejtjet për burimet e mundshme të rrezikut në punë.

### **VENDET E PUNËS ME KUSHTE TË POSAÇME**

#### Neni 55

Punët, respektivisht vendet e punës, në të cilat objektivisht ekziston rrezik i shtuar nga lëndimet dhe dëmtimet shëndetësore, veprimi i dëmshëm i të cilave ndikon në aftësinë punuese dhe shëndetin e punëtorëve, të cilat nuk mund të evitohen me masat e rregullta të mbrojtjes në punë, konsiderohen punë, respektivisht vende pune me kushte të posaçme. Punët në të cilat ekziston rrezik i shtuar nga lëndimet dhe sëmundjet, konsiderohen edhe ato punë e vende pune, në të cilat punëtori u nënshtrohet ngarkesave të posaçme, andaj nevojitet të ndërmerren masa të posaçme të mbrojtjes.

#### Neni 56

Para caktimit të punëtorëve në punët nga neni 55, shërbimi për pranimin e punëtorëve ka obligim të vërtetojë se a i përmbush punëtori kërkesat e vendit të punës, respektivisht kushtet e posaçme të punës, ndërsa gjatë punës bëhet shqyrtimi i kohpaskohshëm i atyre kushteve dhe punëtori duhet të dërgohet në kontrollime priodike mjekësore.

#### Neni 57

Për punë në vendet e punës me kushte të posaçme, punëtorët duhet t'i plotësojnë ato kushte të posaçme të parapara me dispozitat në fuqi dhe sistematizimin e punëve e posaçërisht në aspekt të moshës, përgaditjes profesionale, gjendjes shëndetësore dhe psikike të punëtorit.

## **MBORJTJA E POSAÇME NË PUNË E GRAVE, TË RINJËVE DHE INVALIDËVE.**

### **Neni 58**

Të rinjëve nën moshën 18 vjeçare, invalidët dhe grave u sigurohet mbrojtje e posaçme në punë. Të drejtjat e grave, posaçërisht të lehonave dhe atyre me fëmijë të mitur, të rinjëve nën 18 vjet dhe invalidët e punës, në aspekt të kohës së punës, të të drejtës së pushimit vjetor, të mungesave të paguara dhe të drejtave tjera nga marrëdhënia e punës, më për së afërmi rregullohen me dispozitatat e Kontratës Kolektive dhe Ligjit të punës.

### **Neni 59**

Gratë, të rinjët dhe invalidët në marrëdhënie pune, gjatë punës gëzojnë mbrojtje të posaçme në harmoni me dispozitatat ligjore, këtë Rregullore dhe aktet tjera të Kompanisë.

### **Neni 60**

Në Kompani, puna e femrave është e ndaluar:

- Në të gjitha punët me kushte të posaçme, nëse nuk janë marrë masat e posaçme të mbrojtjes së femrave;
- Puna për bartjen, ngarkim-shkarkimin e peshave mbi 15 kg.;
- Punët në vendet tjera që ndikojnë dëmshëm dhe posaqërisht me rrezik të shtuar, që dëmtojnë shëndetin e femrave;
- Punëtorët më të ri se 18 vjeçarë, gratë shtatzëna, personat me aftësi të kufizuar për punë, nuk mund të sistemohen në punë veçanërisht të rënda, punë më të gjatë se orari i plotë i punës dhe punë të natës.

### **Neni 61**

Punëtori me aftësi të zvogëluar të punës, caktohet në punë të cilat mund t'i kryej para rehabilitimit profesional dhe nëse mund të punojë pa rrezik të zvogëlimit të aftësisë së mbetur të punës sigurohet vendi përkatës i punës. Invalidët e punës mund të caktohen vetëm në vende punë që janë paraparë për invalidët.

### **Neni 62**

Nëse punëtori me aftësi të kufizuar është aftësuar me rehabilitim profesional për punë të caktuara në Kompani, i sigurohet vendi përkatës i punës.

### **Neni 63**

Vendet e punës për invalid dhe punëtorë me aftësi të kufizuar të punës, i cakton Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi i Kompanisë.

## **KONTROLLIMET PERIODIKE DHE SHQYRTIMI I MJETEVE TË PUNËS**

### **Neni 64**

Në afatet e parapara me ligj, do të bëhet shqyrtimi periodik i mjeteve dhe pajisjeve të punës.

Shqyrtimi dhe kontrollimi periodik do të bëhet nga ana e entit të autorizuar, në qoftë se për këtë nuk është autorizuar Kompania.

### **Neni 65**

Mirëmbajtjen e mjeteve të punës, pajisjeve dhe mjeteve prodhuese, mund ta bëjnë vetëm personat e caktuar dhe profesionalisht të aftësuar.

### **Neni 66**

Mjetet e punës, pajisjet dhe mjetet prodhuese, para përdorimit respektivisht lëshuarjes në funksion, duhet të kontrollohen nga personat që i mirëmbajnë.

### **Neni 67**

Referenti i mbrojtjes në punë kujdeset, që Kryeshefi i Kompanisë të informohet me konstatimet e kontrollimeve konkrete, duke iu mundësuar shikimin e procesverbaleve dhe njoftimin me të metat eventuale, me qëllim të sanimit të gjendjes.

Kryeshefi i Kompanisë, është i obliguar që të marrë masa që të metat të evitohen sa më parë, ndërsa për propozimet për adaptime dhe riparime serioze, si dhe për blerjen e pajisjeve të reja, të marrë vendime vet apo në organin drejtues.

### **Neni 68**

Përgaditjet teknike të kryerjes së kontrollimeve dhe të shqyrtimeve periodike të pajisjeve, e bënë shërbimi i mirëmbajtjes i cili edhe mban kontakt me referentin për mbrojtjen në punë dhe organizatën kompetente.

### **Neni 69**

Kryeshefi i Kompanisë ose personi të cilin ai e autorizon, është i obliguar që në kuptim të ligjit për mbrojtje në punë, me vendim të posaqëm të caktoj vëllimin, mënyrën dhe afatet e kontrollimit dhe të shqyrtimit të mjeteve të punës, pajisjeve dhe vegalve, si dhe procedurën e mirëmbajtjes së tyre, në qoftë se kjo nuk është paraparë me dispozitat e mbrojtjes në punë.

## **BLERJA DHE MIRËMBAJTJA E MJETEVE TË MBROJTJES PERSONALE**

### **Neni 70**

Të gjitha mjetet personale të mbrojtjes dhe pajisjet mbrojtëse që i shfrytëzojnë punëtorët, duhet tu përgjigjen dispozitave dhe standardeve të mbrojtjes në punë. Urdhëresën për blerjen e mjeteve personale të mbrojtjes dhe të pajisjeve personale, e jep udhëheqësi i drejtpërdrejt, ndërsa e nënshkruan dhe e lejon Kryeshefi ose personi tjetër i autorizuar në Kompani.

#### Neni 71

Mirëmbajtjen e mjeteve dhe pajisjeve personale të mbrojtjes në punë, e bëjnë punëtorët që janë të ngarkuar me ato mjete dhe pajisje.

#### Neni 72

Në rast se para kalimit të afatit të qëndrueshmërisë dëmtohen mjetet personale dhe pajisjet e mbrojtjes në punë, sa që të njejtat nuk mund të shfrytëzohen me efikasitet, punëtorit, edhe para kalimit të afatit të qëndrueshmërisë i jepet mjete i ri.

#### Neni 73

Obligohet Bordi i Drejtorëve, që në kuptim të Rregullorës të caktoj se në cilat punë respektivisht vende të punës, cilat mjete dhe pajisje (varësisht nga lloji dhe shkalla e rrezikut), shfrytëzohen për evitimin e ndikimit të rreziqeve dhe të dëmeve të përherëshme, dhe cilat janë mjetet për mbrojtje nga veprimet dhe rreziqet e kohë pas kohëshme ose afatshkurta.

### **OBLIGIMET NDAJ INSPEKSIONIT TË PUNËS DHE EVIDENCA PËR LËNDIMET**

#### Nneni 74

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe të mundësimin të punës organeve të inspektionit, punëtori përgjegjës në Kompani ka obligim që në rast paralajmërimit të inspektionit të punës, të mundësoj kontrollimin e papenguar të lokaleve, mjeteve të punës dhe të pajisjeve tjera.

Punëtori përgjegjës është i obliguar, që organeve të inspektionit të punës të lë në dispozicion personin profesional, i cili do të jep shpjegime dhe do të mundësoj kontrollimin e pajisjeve si dhe do të ofroj shënime të nevojshme për mbikqyrjen dhe përmbajtjen e dispozitave të mbrojtjes në punë.

#### Neni 75

Gjatë kontrollimit dhe mbikqyrjes nga organet e inspektionit të punës, detyrimisht prezenton Udhëheqësi i njësisë dhe Referenti i mbrojtjes në punë. Personat nga paragrafi 1 i këtij neni, janë të obliguar që të prezentojnë edhe në rast të kontrollimit nga inspektioni në ndërrimin e dytë dhe të tretë nëse kjo bëhet me kërkesën e inspektionit të punës.

#### Neni 76

Kryeshefi i Kompanisë ose personi përgjegjës të cilin ai e autorizon, kujdeset për ekzekutimin e vendimeve të organit të inspektionit të punës. Organi i inspektionit të punës, duhet të informohet me shkrim, më së voni tetë ditë pas kalimit të afatit, për evitimin e të metave respektivisht parregullësive që i janë urdhëruar me vendim.

#### Neni 77

Raportri i dërguar organit të inspekcionit për ekzekutimin e vendimit të tij, duhet të përmbajë faktet se çka është ndërmarrë, që të metat dhe parregullësit e vërejtura të evitohen, por në qoftëse ato nuk kanë mund të evitohen, duhet të theksohet se cilat janë arsyet e mos përmbushjes së kërkesës nga vendimi, dhe pastaj të theksohen shkaqet për kërkesën e zgjatjes së afatit dhe të jepet propozimi për afat të ri të ekzekutimit të vendimit të tyre.

#### Neni 78

Çdo lëndim në punë, duhet të evidentohet në Kompani. Punëtori i lënduar është i obliguar që çdo lëndim t'ia paraqesë udhëheqësit të drejtpërdrejtë. Udhëheqësi i drejtpërdrejt bënë procesverbal dhe atë ia paraqet Referentit të mbrojtjes në punë në afat prej 24 orësh, duke llogaritur nga momenti i ndodhjes së lëndimit, ndërsa fatkeqësitë më të rënda në punë, duhet të lajmërohen menjëherë. Të dhënat në procesverbal, duhet të jenë të sakta dhe të lexueshme. Udhëheqësi i drejtpërdrejt nëse nuk përfill obligimin nga paragrafi i mësipërm, bartë pasjoat ligjore dhe ftohet në përgjegjësi. Fatëkeqësi në punë konsiderohet çdo lëndim që është në lidhje shkakore me kryerjen e punës, si dhe të marrjes së lëndimeve në udhëtim zyrtar, gjatë ardhjes në punë dhe shkuarjes në shtëpi dhe fatkeqësit tjera të rregulluara me dispozita ligjore.

#### Neni 79

Në vendin ku ndodh lëndimi ose fatkeqësia, nuk guxon të ndërrohet asgjë, derisa të bëhet shikimi. Shikimi përfshinë:

- Shikimi në vendin e ngjarjes;
- Marrjen në pyetje të të lënduarit, dëshmitarëve okluarë dhe udhëheqësit të drejtpërdrejtë;
- Kontrollimin e mjeteve dhe paisjeve të punës;
- Kontrollimin e paisjeve mbrojtëse;
- Kontrollimin e mjeteve dhe paisjeve personale të mbrojtjes;
- Shikimin e rrethanave tjera të rëndësishme për zbulimin e shkakut të lëndimit të punëtorit.

#### Neni 80

Për çdo shikim mbahet procesverbal, në të cilin duhet të konstatohet burimi dhe shkaku i lëndimit dhe eventualisht me fajin e kujt ka ndodhur lëndimi. Me shikimin udhëheqë referenti i mbrojtjes në punë.

#### Neni 81

Në vendin e punës ku ekziston rreziku i lëndimit ose ka ndodhur lëndimi, nuk mund të lejohet puna, përderisa shërbimi kompetent nuk konstaton se janë evituar burimet e rrezikut, respektivisht shkaqet për shkak të të cilave ka mund apo ka ndodhë lëndimi.

#### Neni 82

Referenti i mbrojtjes në punë është i obliguar, që në harmoni me afatet e caktuara, të përgadis dhe përpunojë profesionalisht:

- Raportet lidhur me konstatimet e inspektionit të punës dhe evitimim e të metave të caktuara, si dhe përmirësimin e masave të mbrojtjes në punë për të cilat janë dhënë vendime, procesverbale ose konstatime të posaçme gjatë kontrollimit të gjendjes të mbrojtjes në punë në Kompani;
- Raportin për vdekjen, lëndimin kolektiv apo trupor në punë, si dhe për dukuritë që do të mund të rrezikojnë sigurinë e punëtorëve;
- Raportet lidhur me mbrojtjen në punë ose të dhëna tjera, nëse i kërkon inspekcioni i punës;
- Raportet tjera, shënimet dhe urdhëresat tjera në harmoni me këtë Rregullore dhe Ligjin, si dhe të gjitha paraqitjet dhe evidencat për lëndimet në punë dhe sëmundjet lidhur me punën, si dhe evidencat për aftësimin e punëtorëve.

#### Neni 85

Organi kompetent i inspektionit të punës, duhet të informohet me kohë për çdo rast vdekje, fatkeqësi kolektive në punë, lëndim të rëndë në punë, si dhe për çdo dukuri që do të mund të rrezikojnë sigurinë e punëtorëve.

Informimin sipas rregullit e bën referenti i mbrojtjes në punë, nëse kjo nuk është e mundur, atëherë këtë do ta bëjë drejtpërsëdrejti punëtori përgjegjës.

### **NDIHMJA E PARË NË RAST TË LËNDIMEVE OSE FATKEQËSIVE ELEMENTARE**

#### Neni 86

Ndihmën e parë, punëtorëve në rast të lëndimit, helmimit ose të sëmundjes së hovshme, ua japin punëtorët për dhënien e ndihmës së parë, që kanë provimin e dhënë.

#### Neni 87

Në të gjitha repartet prodhuese në Kompani, në vendet e dukshme dhe të përdorshme, duhet të jenë të vendosura kutitë me mjetet e nevojshme sanitare për dhënien e ndihmës së parë.

Në së paku çdo 50 punëtorë, duhet të ekzistojë 1 kuti sanitare.

#### Neni 88

Në kutinë sanitare duhet të jenë të theksuara numrat e telefonave:

- Të stacionit shëndetësor;
- Të ndihmës së shpejt;
- Të shërbimit të zjarrfikësve;
- Të inspektionit të punës;
- Të policisë;
- Emrat e personave që janë aftësuar për dhënien e ndihmës së parë;
- Të referentit për mbrojtje në punë.

#### Neni 89

Mjetet për dhënien e ndihmës së parë, në kutitë sanitare duhet të përtrihen rregullisht dhe të mirëmbahen, që të jenë çdo herë në gjendje përdorimi.

Udhëheqja me mjetet në kutitë sanitare, i lejohet vetëm referentit të mbrojtjes në punë, si dhe personit të ngarkuar e të aftësuar për dhënien e ndihmës së parë.

#### Neni 90

Në rast të fatkeqësisë elementare, eksplozimit, zjarrit ose fatkeqësisë tjetër masovike, Kompania është e obliguar të organizojë masa për evakuimin e punëtorëve dhe personave tjerë të rrezikuar.

Me qëllim të shpëtimit dhe evakuimit me kohë, Kompania harton planet e evakuimit dhe shpëtimit të punëtorëve.

Planin e evakuimit dhe shpëtimit të punëtorëve, me propozimin e Komisionit për mbrojtje në punë, e miraton Bordi i Drejtorëve.

## **MASAT E PËRGJITHSHME TË MBROJTJES NË PUNË DHE OBLIGIMET PËR KUSHTET E PUNËS**

### **1. Lokalet e punës**

#### Neni 91

Të gjitha lokalet e punës dhe ndihmës, duhet të jenë sipas llojit të punës, të ndriqara mjaftueshëm nga drita natyrore ose artificiale dhe të njejtat duhet kontrolluar në afatet e parapara me standarde dhe ligj.

#### Neni 92

Në lokalet e punës ku punohet me ujë dhe ku derdhet uji, dyshemet duhet të jenë nga materiale jodepërtues dhe me rënie në drejtim të hapjes.

#### Neni 93

Temperatura, lagështia dhe lëvizja e ajrit në lokalet e punës, duhet të jenë të harmonizuara me vlerat e parapara për vendet e punës dhe të verifikohen në aftatet e parapara me ligj.

#### Neni 94

Lokalet e punës ku përdorën materialet e prirua për ndezje dhe eksplozim, mund të ngrohen vetëm në atë mënyrë që rreziku nga zjarri dhe eksplozimi të përjashtohen tërësisht.

#### Neni 95

Në lokalet prodhuese dhe të punës, duhet të sigurohet ventilimi natyror dhe artificial sipas dispozitave.

Këto lokale duhet të kontrollohen kohpaskohe po qe se në to paraqiten gazra, avujt, pluhuri dhe dëmtuesit tjerë kimik.

## **2.3 Mjetet e punës**

### **Neni 96**

Mjetet e punës dhe veglat që përdoren gjatë punës, mund të përdoren vetëm për qëllimin e caktuar, për të cilin janë të dedikuara. Pajisjet sigurose dhe mbrojtëse në mjetet e punës, mund të përdoren vetëm për dedikimin e tyre. Ato duhet përdorur me kujdes dhe pas përdorimit duhet të pastrohen dhe të vendosen në vendin e tyre të caktuar.

### **Neni 97**

Është i ndaluar shfrytëzimi i padedikuar dhe heqja arbitrare e paisjeve mbrojtëse, si dhe dëmtimi i tyre i qëllimshëm.

Të metat dhe prishjet duhet lajmëruar menjëherë udhëheqësit të drejtpërdrejtë. Largimi i paisjeve mbrojtëse dhe i veglave mbrojtëse, mund të bëhet vetëm në rast të nevojës dhe atë nga personi i autorizuar. Pas pushimit të kësaj nevoje, paisjet mbrojtëse duhet kthyer në gjendjen e mëparshme.

### **Neni 98**

Mirëmbajtjen e mjeteve të punës dhe paisjeve, aparateve dhe mjeteve prodhuese, mund ta bëjnë vetëm punëtorët e caktuar dhe profesionalisht të aftësuar për këtë punë.

### **Neni 99**

Makinat, veglat, paisjet, mjetet ndihmëse (shkallët, aparatet e të ngjashme), qoftë kur janë të reja ose të riparuar, para përdorimit duhet të provohet siguria e tyre.

### **Neni 100**

Kazanët, enët nën presion dhe të gjithë gypat përcjellës në aspekt të sigurisë, duhet t'u përgjigjen dispozitave të caktuara teknike në lëmitë përkatëse dhe periodikisht të kontrollohen në afatet e parapara me standarde dhe ligje.

### **Neni 101**

Transportimi, ngarkimi dhe shkarkimi i materialeve, elementeve dhe të mallit, mund të bëhet vetëm me mjete transportuese, në gjendje të rregullt, sipas dispozitave në fuqi.

## **3. Zhurma dhe vibracionet**

### **Neni 102**

Zhurma dhe vibracionet, duhet të zvogëlohen në të gjitha lokalet e punës, në kufirin më të ulët të lejuar sipas dispozitave dhe standardeve, dhe duhet të kontrollohen periodikisht në afatet e parapara me dispozita dhe standarde teknike.

## **4. Rryma elektrike dhe rrezatimet e brendshme**

### **Neni 103**

Në loaket me paisje elektrike të tensionit të lartë, u lejoheq qasja vetëm punëtorëve të caktuar profesional. Lokalet e tilla duhet të jenë gjithnjë të mbyllura, nëse në to nuk ndodhen punëtorët autorizuar.

#### Neni 104

Të gjitha instalimet elektrike të reparteve motorrike dhe të ndriqimit, duhet të jenë të realizuara në harmoni me dispozitat dhe standardet teknike, varësisht nga procesi teknologjik që kryhet.

Të gjitha mjetet dhe pajisjet e punës, duhet të jenë të tokëzuara dhe të mbrojtura nga tensionet e rastësishme të prekjes dhe periodikisht të kontrollura në aftatet e parapara me ligj dhe standarde.

Çdo punë nën tension është e ndaluar.

Të gjitha pajisjet elektrike duhet të kenë tiketën në të cilën shënohen karakteristikat e tyre me simbolin CE.

#### Neni 105

Nga rrufeja, duhet të jenë të mbrojtura të gjitha objektet, ndërtesat, punëtorit, depot etj., sipas dispozitave në fuqi.

### **5. Materiet e rrezikshme e të dëmshme dhe mbrojtja nga zjarri**

#### Neni 106

Materialet ndezëse, eksploduese, të nxehta, helmuese dhe brejtëse, mund të mbahen vetëm në enët e përshtatshme dhe vende të sigurta, të mbyllura dhe nën mbikqyrje.

#### Neni 107

Gjatë punës me materie ndezëse, eksploduese dhe lëngje të rrezikshme, rreptësisht ndalohet pirja e duhanit, përdorimi i zjarrit të hapur dhe i mjeteve të ndezura.

Në ato punë, nuk guxon të përdoren veglat dhe paisjet të cilat mund të prodhojnë shkëndija.

#### Neni 108

Ndrimi i brendisë së kazanave, cisternave, rezervuarëve, kanaleve etj, në të cilat mund të këtë gazra ndezëse dhe eksploduese, mund të bëhet vetëm me llampa elektrike të punuara me mbrojtëse siguroese dhe me tension të ulët.

## **MASAT E POSAÇME TË MBROJTJES NË NJËSIT PUNUESE**

### **1. Njësia punuese për mirëmbajtje**

#### **a/. Punëtorja mekanike**

#### Neni 109

Në punëtorinë mekanike masat e mbrojtjes në punë të punëtorëve janë paraparë për shkak të rreziqeve mekanike që vijnë gjatë punës së veglave, mjeteve të punës dhe paisjeve. Me dispozitat e mbrojtjes në punë, në punëtorinë mekanike janë përfshirë grupet e punëve mekanike, të farkuesve, salduesve dhe të vegëltores.

#### Neni 110

Të gjitha objektet që përpunohen në shpuese, duhet të jenë të siguruar nga mundësia e lëvizjes jo vetëm me dorë, por me pykën siguroese dhe përforcuesin.

#### Neni 111

Lokali në të cilin bëhet saldimit, duhet të jetë i gjërë, i ndrikuar dhe i ajrosur. Në qoftë se ventilimi natyror nuk është i mjaftueshën, duhet përdorur ventilimin artificial dhe në qoftë se saldimit bëhet në hapsirë të ngushtë, siç janë kazanat, rezervuaret etj., me ç`rast duhet dhënë përparësi saldimit elektrik krahas kushteve tjera të sigurimit për energjinë elektrike gjatë saldimit, këto hapsira duhet të jenë të ajrosura, duke shtuar ajrin e pastër dhe thithur atë të ndyrë.

#### Neni 112

Mirëmbajtja, riparimi dhe puna me aparatit e saldimit, mund të bëhet vetëm nga personi i aftësuar, pa prezencën e të cilit nuk mund të bëhet asnjë manipulim me aparat. Është i ndaluar çfarëdo zëvendësimi në aparatit për ngjitje autogjene. Riparimi, çfardo qoftë, mund të bëhet vetëm kur aparatit nuk punon. Gjatë përdorimit të aparatit për ngjitje autogjene, personi përgjegjës duhet t`u përmbahet rreptësisht dhe vazhdimisht udhëzimeve origjinale të dhëna nga prodhuesi i aparatit, si në aspekt të kryerjes së manipulimeve të caktuara, ashtu edhe në radhën e operacioneve gjatë përdorimit.

### **b/. Punëtorja elektrike**

#### Neni 113

Punëtorja elektrike si faktor i rëndësishëm në zbatimin e sigurisë në punë, ka për detyrë që të gjitha pajisjet dhe instalimet elektrike, t`i mbajë në gjendje të rregullt dhe pajisjet e instalimeve të vjetra t`i zëvendësojë.

Udhëheqësi i instalimeve elektrike, bën tërë kontrollin dhe mbikqyrjen e gjendjes së instalimeve elektrike, e posaçërisht kujdeset që të zbatohet mbrojtja e transformatorëve, instalimeve shpërndarëse dhe posaçërisht kujdeset që të zbatohet mbrojtja e transformatorëve, tabela shpërndarëse, siguresave, ndërprerësve, prizave etj.

Udhëheqësi i shërbimit elektrik, duhet të hartojë kushtet e rjetit elektrik me skemën, ndërsa elektrikistët janë të obliguar që në reparte dhe në punëtori, t`i zbatojnë këto dispozita dhe posaçërisht të kujdesen për mbrojtjen nga tensioni i prekjes dhe tokëzimi.

#### Neni 114

Secili udhëheqës i njësive punese është i obliguar që t`i lajmrojë të gjitha defektet e pajisjeve elektrike, instalimeve dhe aparateve.

Paraqitjen ia bën punëtorisë elektrike.

Elektrikistët kujdestar, janë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe gjendjen e pajisjeve teknike ndaj kryepunëtorit të tyre dhe janë të obliguar që ta lajmërojnë për çdo prishje. Për sigurimin e ndriqimit dhe evitimin e prishjeve në elektroinstalime, janë përgjegjës elektrikistët dhe atë secili në rajonin apo objektin që e mbulon.

#### Neni 115

Paisjet elektrike, instalimet dhe aparatet, duhet të jenë të vendosura sipas dispozitave të standardeve në fuqi, respektivisht të normave të obligueshme apo dispozitave dhe përvojave të mirënjohura teknike. Kjo ka të bëjë edhe me llojin e materialit të instaluar. Të gjitha punët në instalimet dhe paisjet elektrike, duhet të bëhen ekskluzivisht nga persona të kualifikuar dhe posaçërisht të aftësuar, që janë të ngarkuar për reparte, paisje, aparate etj.

Elektracisti mban përgjegjësi të plotë, për kualitetin dhe rregullsinë e riparimeve.

#### Neni 116

Punëtorët që udhëheqin me motor dhe paisje elektrike, janë të obliguar që të njohin dispozitat për përdorimin e sigurve dhe profesional të tyre. Ata janë përgjegjës për to dhe nuk guxojnë të lejojnë që me to të udhëheqin personat joprofesional dhe të paautorizuar. Udhëzimet për punë me elektromotorë dhe paisje duhet të jenë të theksuara në vend të dukshëm, afër vendit të punës.

Çdo punëtor që punon në makinë apo paisje, është i obliguar që në rast të ndërprerjes së rrymës elektrike, ta shkyq makinën ose paisjen, me përjashtim të paisjeve elektrike që shkyqen në mënyrë automatike.

Punëtori është përgjegjës për pasojat që ndodhin me fillimin e punës së makinës ose paisjes pas kyqjes së sërishme të rrymës elektrike, nëse ajo nuk ka qenë e shkyqur.

### **c/.Punëtorë e ndërtimtarisë**

#### Neni 117

Për punë muratorie, si dhe për të gjitha punët shërbyese mbi tokë, skelet duhet të jenë të forta dhe të sigurta. Ato duhet të jenë të ndërtuara, kufizuara dhe montuara nga punëtorët e përgaditur dhe të prirur për kryerjen e punëve të tilla, nën mbikqyrjen e udhëheqësit të drejtpërdrejtë.

### **3. Njësia punuese e transportit**

#### Neni 118

Pas mbarimit të ngarkimit të automjetit, vozitësi është i obliguar të vërtetojë se a është ngarkesa e vendosur sipas rregullit, ndërsa te automjetet me anësore të vërtetojë se a janë të mbyllura mirë.

Në qoftë se ngarkimin dhe shkarkimin në automjet të sasive të mëdha të ngarkesës e bën grupi i punëtorëve, puna e tillë duhet të kryhet nën kontrollin e punëtorit të caktuar për këtë, i cili para fillimit të punës vërteton gjendjen e paisjeve për shkarkim dhe ngarkim.

Gjatë ngarkimit dhe shkarkimit në automjete të ngarkesave eksplozive dhe me prirje të ndezjes së lehtë, ndalohet pirja e duhanit.

Neni 119

Riparimet e mëdha dhe të mesme të automjetit, si dhe furnizimi i tij me lëndë djegëse dhe lyrëse, bëhet në vendin e caktuar-puntori, e cila duhet të jetë e pajisur me aparatet e nevojshme, veglat dhe mjetet tjera për kryerjen e punëve.

Riparimet e vogla mundë të bëhen edhe jashtë vendit të caktuar, me kusht që të ndërmerren masat e mbrojtjes.

Në qoftë se riparimet bëhen në automjet, automjeti duhet të jetë i vendosur në mbështetës të sigurtë e të fortë.

Neni 120

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e aprovimit të së njëjtës nga Bordi i Drejtorëve të K.R.U “ Hidroregjioni Jugor” SH. A. – Prizren.

Datë : 20.05.2011

Prizren

KRU “ Hidroregjioni Jugor” SH. A. – Prizren

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

Dr.sc.Naser Bajraktari

